

RELACION TEKNIK

PËR REALIZIMIN E STUDIM - PROJEKTIMIT:

“RIKONSTRUKSIONI I KOPSHTIT “SKENDERBEG”, LEZHË”

BASHKIA LEZHË



Lezhë, 2025

1. TË PËRGJITHSHME

1.1 Të dhëna të përgjithshme

- Objekti: Rikonstruksioni i kopshtit “Skenderbeg”, Lezhë.
- Vendndodhja: Bashkia Lezhë

Lezha si qytet dhe biostrukturë përfaqëson diçka shumë të rëndësishme dhe të veçantë. Nga pikëpamja gjeometrike dhe ekologjike, Lezha, përbën një kaleidoskop të mrekullueshëm të natyrës, gati një lloj principate të pashembullt ekologjike, ku mali, fusha, pylli, monumentet arkeologjike dhe historike, laguna dhe deti përbëjnë një bashkësi të spikatur. Në këtë kuptim, Lezha, është e preferuara e shekujve, një sintezë e veprës së natyrës e të njerëzve me një vesk të ndritshëm të historisë e artit. Në portat e Lezhës mund të hysh pa trokitur, dhe duke e njohur fytyrën dhe thelbin e saj, vetëm mund të magjepsesh pambarimisht.

Lezha është një grishje e përhershme dhe një estetikë e gjallë e sendeve dhe qytetërimit iliro-shqiptar, një stacion diturak i mijëvjeçarëve dhe i kënaqësive të veçanta të banorëve dhe të udhëtareve. Çdo tregim mitologjik për Lezhën i paraprin historisë së saj plot motive dhe kontraste nga më të ndryshmet. Jo më kot, kronikania dhe eruditja bizantine Ana Komnena, në shek. XII, e quan Lezhën ***një qytet të ngritur në ajër***, që mund të shihet nga të gjitha anët. Nuk është thjesht metafore e skajshme, por vetvetiu çdo shikues mund t'a vështrojë Lezhën në lartësinë e historisë së saj, në ajrin e shekujve si të dale nga frymëmarrjet poetike të poetit Ndre Mjeda, që ka shkruar mrekullisht për Lezhën. Ku nga të kater anët, të rrethojnë metaforat e historisë; çdo njeri jeton midis tyre dhe këtu qëndron vetë sekreti i mbijetesës.

2. POZITA GJOGRAFIKE

Bashkia Lezhë ndodhet në pjesën veriperëndimore të Shqipërisë, e shtrirë në koordinatat afërsisht 41.78°V, 19.65°L, në një lartësi mesatare prej rreth 20-30 metrash mbi nivelin e detit. Qyteti i Lezhës ndodhet pranë grykëderdhjes së lumit Drin dhe përshkohet nga degëzimet e tij që derdhen në Detin Adriatik, duke i dhënë një karakteristikë të veçantë gjeografike dhe ekologjike. Lezha ka një sipërfaqe të qytetit që shtrihet në mënyrë të zgjatur përgjatë fushës së Zadrimes dhe është e rrethuar në perëndim nga zona bregdetare dhe laguna e Kune-Vainit, ndërsa në lindje ngrihen kodrat e ulëta të malësisë së Lezhës. Pozita e saj gjeografike është mjaft e favorshme, pasi ndodhet në një pikë lidhëse midis Tiranës, Shkodrës, Durrësit dhe Kosovës, duke u bërë një nyje e rëndësishme rrugore dhe ekonomike.

Qyteti i Lezhës është ndërtuar në një shtrirje urbane me strukturë të rregullt, ku rrjeti rrugor është i organizuar në mënyrë të tillë që të ndihmojë qarkullimin e brendshëm dhe lidhjet me rrugët kryesore kombëtare, veçanërisht aksin Tiranë–Shkodër dhe rrugën që të çon drejt Shëngjinit. Zona urbane ndahet në lagje me karakteristika të ndryshme funksionale, ku ndërtesat e banimit

ndërthuren me objektet shërbimore dhe institucionale. Rrjeti i jashtëm rrugor përshkon qytetin në drejtimin veri–jug dhe kalon pranë zonës industriale dhe tregtare, duke shmangur trafikun në qendrën historike të qytetit.

Vlen të theksohet se qendra e qytetit të Lezhës është e përqendruar në pjesën jugore dhe qendrore të qytetit, afër Kalasë së Lezhës dhe vendit të Besëlidhjes së Skënderbeut, duke ruajtur një vlerë të lartë historike e kulturore. Ajo përbëhet nga sheshi kryesor, shëtitorja buzë lumit Drin dhe parku përreth monumenteve historike, ku ndodhen institucionet kryesore administrative, sociale dhe kulturore të qytetit

Kopshti “Skënderbeg” ndodhet në lagjen Skënderbeg, pranë sheshit “Gjergj Kastrioti”, në qytetin e Lezhës. Zona është një pjesë qendrore e qytetit, me akses të lehtë nga rrugët kryesore dhe shërbime të ndryshme publike. Pjesa e kopshtit është vetëm në katin e parë të godinës duke përfshirë dy klasa, dy dhoma gjumi, dy tualete, një kuzhinë dhe drejtoria. Ku ky objekt afërsisht është 200 m² ndërtim.



3 KLIMA DHE HIDROLOGJIA

Zona ku do të zhvillohet projekti karakterizohet nga një klimë mesdhetare me ndikime kontinentale, duke sjellë dimra të butë e me reshje dhe vera të thata e të nxehta. Temperatura në sezonin e dimrit zakonisht luhet nga -2°C deri në -6°C, ndërsa në verë arrijn vlera të larta nga +32°C deri në +38°C, me një temperaturë mesatare vjetore rreth +15°C. Temperatura mesatare e ajrit varion në intervalin 12°C – 14°C, në përputhje me pozicionin gjeografik dhe afërsinë me detin.

Diellëzimi mesatar vjetor është rreth 55-58 kkal/cm², me zgjatje faktike që varion nga 60 orë në muajin Dhjetor, deri në 320 orë në muajin Korrik. Në total, numri i orëve me diell në vit është rreth 2600, duke siguruar kushte të favorshme ndriçimi natyral gjatë pjesës më të madhe të vitit.

Lagështia mesatare vjetore e ajrit është rreth 70%, me vlera më të larta gjatë dimrit dhe më të ulëta në verë, veçanërisht gjatë muajve Korrik dhe Gusht.

Reshjet mesatare vjetore variojnë nga 1000 mm deri në 1300 mm, duke qenë më të theksuara në stinën e dimrit dhe në fillim të pranverës. Muajt me reshjet më të mëdha janë Nëntori, Dhjetori dhe Janari, ndërsa muajt më të thatë janë Korriku dhe Gushti. Numri mesatar i ditëve me reshje në vit është rreth 120-140 ditë. Reshjet maksimale vjetore mund të arrijnë deri në 1600 mm, ndërsa vlera minimale nuk bie zakonisht nën 800 mm në vit. Reshjet intensive të shiut, për një kohëzgjatje 24 orëshe me siguri 10%, janë vlerësuar deri në 95 mm, ndërsa për 12 orë arrijnë rreth 80 mm.

Në dimër, reshjet me borë janë të rralla dhe zakonisht nuk krijojnë shtresa të konsiderueshme për shkak të klimës së butë të zonës bregdetare. Megjithatë, në zonat kodrinore dhe malore të rrethinës së Lezhës, mund të krijohen shtresa të përkohshme bore me trashësi nga 10 cm deri në 30 cm, që zakonisht qëndrojnë për pak ditë.

Regjimi i erërave është i ndryshueshëm, me ndikim të ndjeshëm nga afërsia me detin Adriatik dhe konfigurimi i relievit. Qetësia e erës vlerësohet rreth 55-60% të kohës, ndërsa drejtimet më të zakonshme janë ato verilindore, jugperëndimore dhe perëndimore, sidomos gjatë sezonit të verës. Erërat veriore dhe verilindore mbizotërojnë gjatë dimrit me rastisje mbi 20-25%, ndërsa në pranverë dhe verë dominojnë erërat nga jugu dhe jugperëndimi për shkak të ndikimit të rrymave të ngrohta dhe lagështuese nga deti.

1.4 GJEOLOGJIA

Ndërtimi gjeologjik i zonës së Lezhës përfaqësohet kryesisht nga depozitime të kuaternarit të sipërm dhe aluvione të formuara nga aktiviteti i lumenjve dhe faktorët detarë. Këto depozitime janë të vendosura mbi formacione më të vjetra të pliocenit dhe miocenit, të cilat ndodhen në thellësi më të madhe dhe nuk janë gjithmonë të ekspozuara në sipërfaqe.

Shtresat sipërfaqësore përbëhen kryesisht nga materiale aluvionale të pazgjedhura, të cilat kanë trashësi nga 4 m deri në 8 m, në varësi të pozicionit topografik dhe afërsisë me rrjetin ujqor. Këto depozitime përfshijnë rërë të imët dhe të mesme, zhavorr, argjila dhe silt, me përzierje të pjesshme me materiale organike në shtresat më të sipërme, veçanërisht pranë zonave të kënetave të dikurshme ose terreneve të luginave të mbushura. Në disa pjesë janë të pranishme edhe depozitime terrigjene me origjinë detare dhe lagunare, që përmbajnë shtresa argjilore-plastike dhe suargjilore, të cilat shfaqin ngarkesa të ulëta mbajtëse dhe përbëjnë faktor të rëndësishëm për vlerësimin gjeoteknik të terrenit ndërtimor. Në zonat periferike, në afërsi të kodrinave dhe kontakteve me formacione më të larta gëlqerore, hasen edhe konglomerate të dobëta dhe rërëra të çimentuara pjesërisht, me përbërje të përzier nga fragmente gëlqerore dhe zaje kuarci.

Këto karakteristika e bëjnë zonën e Lezhës të larmishme nga ana gjeologjike, me një bazë të butë deri mesatarisht të qëndrueshme, që kërkon analizë të kujdesshme të kushteve themelore për

vendosjen e themeleve dhe dimensionimin e strukturave, sidomos në zonat me ujëra nëntokësore ose me prani të shtresave argjilore me potencial të ulët mbajtës.

4.MENYRA E REALIZIMIT TE PROJEKTIT

Ashtu sic edhe është kërkuar edhe nga detyra e projektimit, Projekti do të realizohet ne tre faza. Faza e pare Skice - idea, e paraqitur tashme, faza e dyte Projekt – ideja dhe faza e trete Projekt – zbatimi, qe paraqitet ne kete raport.

5.RILEVIMI TOPOGRAFIK

Për hartimin e Relievit të zones si dhe të perpilimit të planimetrisë, prerjeve te fasadave jane kryer matjet topografike ne terren. Matjet jane kryer me Stacion Total tip Leica TC 307 nga i cili merren ne trajte dixhitale koordinatat X, Y, Z te cdo pike. Pikat e matura perpunohen ne programet kompiuterike sipas karakteristikave te tyre te percaktuara qarte ne terren nga grupi i punes. Ne per fundim perftohen Planimetria tredimensionale e objektit si dhe Profilat gjatesore e terthore te objektit. Ato kane sherbyer si baze per hartimin e tere projekt-zbatimit. Ne terren jane te shenuara stacione poligonale qe mund te sherbejne per piketimin e objektit

6.QELLIMI I RIKONSTRUKSIONIT

Rikonstrukcioni i Kopshtit Skenderbeg ka një rëndësi të madhe krijimin e kushteve më të mira për fëmijët dhe në zhvillimin arsimor dhe kulturor të qytetit. Objektivi kryesor është hartimi i detajuar dhe studimi i gjendjes aktuale të objektit duke bërë që cilësia e rezultatit final të ketë arritur standartet e kërkuara bashkëkohore. Si një pikë tjetër e rëndësishme është dhe plotësimi i kushteve teknike pasi objekti do i nënshtrohet një rikonstrukcioni të brendshëm dhe të jashtëm.

7.GJENDJA EKZISTUESE E OBJEKTIT DHE ANALIZA E SAJ

Analiza e gjendjes ekzistuese

Objekti në fjalë, i cili shërben si një strukturë edukative për fëmijët e moshës parashkollore, përbëhet nga dy grupe të organizuara në dy klasa të ndara, ku secili grup ka në dispozicion një dhomë fjetjeje dhe një tualet përkatës. Objektit i mungojnë kushtet minimale higjieno-sanitare dhe funksionale për të garantuar zhvillimin normal të aktiviteteve edukative dhe sociale të fëmijëve, si pasojë e një sërë problematikash që lidhen me gjendjen fizike, teknike dhe funksionale të tij. Në të gjithë objektin është evidentuar prania e lagështirës, e cila përqendrohet kryesisht në muret

perimetrale dhe dysHEME, por është gjithashtu e pranishme në muret e brendshme dhe ambientet ndihmëse si kuzhina. DysHEMEja është e shtruar me drrasa druri të vjetra dhe të amortizuara, të cilat jo vetëm që nuk sigurojnë komoditetin e nevojshëm për fëmijët, por përbëjnë dhe rrezik për higjienën dhe sigurinë e tyre. Suvatimet janë të dëmtuara nga lagështira.

Instalimet hidraulike janë të amortizuara dhe paraqesin probleme të funksionimit, me rrjedhje të mundshme dhe presion të dobët të ujit, çka ndikon drejtpërdrejt në standardin e shërbimeve bazë. Çdo grup ka në dispozicion vetëm një banjo, e cila nuk është e ndarë sipas gjinisë, në kundërshtim me praktikën bashkëkohore dhe udhëzimet për objektet e arsimit parashkollor. Kjo krijon kufizime në përdorimin paralel të ambienteve sanitare dhe nuk garanton intimitetin dhe higjienën personale të fëmijëve. Rrjeti elektrik është i dobët. Kuzhina, si një hapësirë funksionale e domosdoshme për përgatitjen dhe shpërndarjen e ushqimit, është në një gjendje të amortizuar dhe nuk përmbush kriteret teknike dhe higjienike të përcaktuara nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU). Në këtë ambient vërehet lagështi e lartë, si dhe mungesë e izolimit të gazit sipas standardeve, duke paraqitur rrezik të drejtpërdrejtë për sigurinë e stafit dhe fëmijëve.

Dritaret dhe dyert janë të amortizuara, me mungesë izolimi termik dhe akustik, gjë që ndikon negativisht në kushtet e brendshme të mikroklimës dhe kursimin energjetik. Edhe pse objekti është i pajisur me një sistem të instaluar për ngrohje dhe ftohje, ai nuk është funksional, duke e bërë të pamundur garantimin e kushteve klimatike të përshtatshme gjatë gjithë vitit.



(FOTO NGA AMBJENTET E JASHTME)

Objekti nuk disponon një sistem funksional për ngrohje dhe ftohje, duke e bërë të pamundur shfrytëzimin e tij në kushte të përshtatshme klimatike gjatë gjithë vitit. Nga ana strukturore, vlen


të përmendet nevoja për përforcimin e kolonës qendrore të godinës, e cila luan një rol të rëndësishëm në mbajtjen dhe stabilitetin e structures.




(FOTO NGA AMBIENTET E BRENDSHME)

8. KONCEPTI I PROPOZUAR PËR NDËRHYRJE

Propozimi synon rehabilitimin e plotë të objektit duke adresuar problemet e lagështirës, ndriçimit, mungesës së hapësirave funksionale. Ndërhyrja përfshin riorganizim të ambienteve, instalim të rrjeteve të reja teknike dhe krijimin e kushteve të përshtatshme për akomodimin e fëmijëve dhe procesin arsimor. Parashikohet ndërhyrje në hapsirën e tualeteve duke krijuar ndarje të reja. Muret ekzistues do trajtohen me shembje të suvasë dhe vendosje suva të re. Për lysterjen parashikohet të përdoren ngjyra të ngrohta të qeta të cilat krijojnë efekt pozitiv në mendjen e fëmijëve. Tavanet parashikohen me ulje gipsi për ambientet e qëndrimit dhe fjetjes. Zevendesim i dritareve dhe i dyerve. Si dhe ritrajtim i nyjeve higjienos-sanitare. Ambientet do të trajtohen gjithashtu me piktura murale.




(PLAN I MOBILIMIT)




(PLANI PER SHTRIM DHE VESHJE)

PRERJE A-A



Detaj i shtresave



PAMJE 3D

MOBILIMI I ILUSTRUAR NE PAMJET E PARAQITURA TE PROJEKTIT, NUK KANË TERMA TË KONTRATËS SË NËNSHKRUAR DHE NUK JANË PJESË E PËRFSHIRË NË PREVENTIV. JANË THJESHTË PËR QËLLIM ILUSTRIMI TË AMBIENTEVE TË PËRFUNDUARA.









PAMJE 3D, pjesa 2





PERGATITI

SHOOQERIA "PROGREEN" SHPK

ADMINISTRATOR/E

SONILA UKPERAJ